

Kjo foto është bërë para shumë vjetëve, kur presidenti aktual turk, Recep Tayip Erdogan, ende nuk ka pasur ndonjë post të lartë politik. Në foto ai është me Hafëz Idrisin nga Shkupi, imam i dikurshëm i xhamisë së Mustafa Pashës dhe njëri ndër hoxhallarët më me zë në historinë më të re të kryeqytetit të Maqedonisë, raporton “Lajm”.

Bashkëpunëtorë të Erdoganit në disa raste kanë thënë se presidenti i sotëm turk gjatë karrierës së tij ka shfrytëzuar dhe aplikuar shumë këshilla të marra prej Hafëz Idrisit, tani të ndjerë.

